



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.17.6-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË KOSOVARE TË**  
**PRONËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikatat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë Kosovare të Pronës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Shkëlqim Xhema (Udhëheqës Ekipi), Arta Birinxhiku dhe Burbuqe Idrizi (Anëtare Ekipi).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	9
4 Qeverisja .....	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	22


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja menaxhmentin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 12.10.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)**.

### Konkluzioni i përgjithshëm

Kontrollet e brendshme efektive kanë siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi qenë në gjendje të marrim siguri nga këto kontrolle për shumicën e fushave të PVF-ve.

AKP ka përdorur mbi 95% të buxhet final, realizim i njëjtë me atë të vitit 2013. Kontrollat mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira, me përjashtim të investimeve kapitale. Kontrollat efektive kishte edhe të menaxhimit të hyrave dhe të menaxhimit të pasurisë.

Mirëpo, pavarësisht progresit të bërë, në disa fusha nevojiten përmirësime të mëtutjeshme. Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



### **Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2014**

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë Kosovare të Pronës (më tutje AKP) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzioni i përgjithshëm

AKP ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të ishin të përgatitura në pajtim të plotë me kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullores MF - Nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

### 2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

#### Përshkrimi

PVF-të e AKP-së, përfshirë edhe të gjitha kërkesat tjera për raportim duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Pajtueshmërinë me Rregullën MF - nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e rregullores nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;

- Kërkesat e rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Kërkesat nga rregulla financiare nr.02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me pajtueshmërinë e kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi çështje për të ngritur.

### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **3 Rekomandimet e vitit paraprak**

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Pavarësisht zotimit të menaxhmentit për të adresuar të gjitha rekomandimet, niveli i adresimit të tyre ishte shumë i ulët. Si rrjedhojë problemet e njëjta vazhdojnë të përsëriten në vazhdimësi.

### **Përshkrimi**

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e AKP-së për vitin 2013 ka rezultuar me tri rekomandime kryesore. AKP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen rekomandimet.

AKP nuk kishte arritur të adresojë asnjë nga rekomandimet e dhëna. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

## Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Rekomandimet nuk janë adresuar. Nuk ishte aplikuar një proces për të menaxhuar dhe monitoruar procesin e adresimit të rekomandimeve bazuar në planin e përgatitur për veprim.
- Rekomandimi lidhur më rishikimin e mundësisë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së, nuk është i aplikueshëm pasi që nga muaji shkurt 2015 donacionet për këto qëllime janë ndërprerë.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare dhe të cilat nuk janë adresuar, kanë rezultuar në:
- Planifikimi dhe realizimin e shpenzimeve jo sipas planifikimit; dhe
  - Dobësi në kontrollin e pagesave.
- Rekomandimi 1** Drejtori ekzekutiv duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të AP-së, me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta kohore.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar si në vijim nga AKP-ja:

- Vetëvlerësimi – është kryer në përputhje më rregullat e MFK-së, duke i shërbyer si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme;
- Menaxhimi i rrezikut – AKP nuk ka aprovuar/aplikuar ndonjë procedurë formale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve operationale në nivel të organizatës. Mirëpo ata kanë bërë një vlerësim të rreziqeve përmes raportit vjetor dhe planit strategjik;
- Raportimi i menaxhmentit – në baza të rregullta në të cilat është diskutuar në detaje menaxhimi i buxhetit dhe çështje tjera rreth aktiviteteve operative; dhe
- Auditimi i brendshëm - Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte realizuar disa raporte të auditimit për menaxhmentin, duke i prioritizuar fushat më rrezik më të lartë. Ato ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve.

Kontrollet e brendshme efektive kanë siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi qenë në gjendje të marrim siguri nga këto kontrolle për shumicën e fushave të PVF-ve.

AKP ka përdorur mbi 95% të buxhet final, realizim i njëjtë me atë të vitit 2013. Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira, me përjashtim të investimeve kapitale. Kontrollet ishin efektive edhe te menaxhimi i të hyrave dhe te menaxhimi i pasurisë. Megjithëse te menaxhimi i procesit të prokurimit ende janë identifikuar disa parregullsi.

## 4.1 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për AKP-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,782,000</b>	<b>3,074,515</b>	<b>2,933,180</b>	<b>3,333,180</b>	<b>3,388,920</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,782,000	1,748,857	1,690,324	1,734,992	1,747,031
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	-	-	-	-	11,160
Donacionet e jashtme	-	1,325,658	1,241,656	1,598,188	1,630,729
Fondi i mirëbesimit	-	-	1,200	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,292,515€. Në vitin 2014, AKP ka shpenzuar mbi 95% të buxhetit final ose 2,933,180€, nivel i njëjtë me atë të vitit 2013. Realizimi i mirë i buxhetit ishte edhe sipas kategorive ekonomike, me përjashtim të investimeve kapitale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të Agjencisë të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,782,000</b>	<b>3,074,515</b>	<b>2,933,180</b>	<b>3,333,180</b>	<b>3,388,920</b>
Pagat dhe Mëditjet	956,462	2,030,551	1,946,110	1,850,165	1,841,545
Mallrat dhe Shërbimet	635,028	872,931	842,565	1,283,695	1,346,226
Shërbimet komunale	96,510	100,523	99,627	119,969	131,794
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	6,000	-
Investimet Kapitale	94,000	70,510	44,878	73,351	69,355

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ka pësuar një rritje për 1,074,125€. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i vendimit të Qeverisë për rritje të pagave me 25% i aplikuar nga muaji prill si dhe donacioneve të pranuar për financimin e pagave në vlerë 913,499€;
- Te mallrat dhe shërbimet buxheti ishte rritur për 273,903€. Fillimisht buxheti fillestar ishte reduktuar për 95,254€ si rezultat i kursimeve me vendimin e Qeverise Nr.07/172. Mirëpo, më pas buxheti ishte rritur si rezultat i transferit prej 5,000€ nga investimet kapitale si dhe pranimit i donacioneve për 328,157€;
- Edhe te komunalitë ishte rritur buxheti final për 4,013€. Fillimisht ishte reduktuar për 14,477€ si rezultat i kursimeve me vendimin e Qeverise. Mirëpo, më pas buxheti ishte rritur si rezultat i transferit prej 18,490€ nga investimet kapitale; dhe
- Buxheti i final për investime kapitale ishte reduktuar për 23,490€. Bazuar në aprovimet e Ministrisë së Financave (MF), 5,000€ ishin transferuar të investimet kapitale dhe 18,490€ të komunalitë.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Kosovës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	-	22,431	22,431	34,848	0
Donacionet e jashtme	-	1,208,179	1,208,179	1,672,662	1,222,730
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>1,230,610</b>	<b>1,230,610</b>	<b>1,707,510</b>	<b>1,222,730</b>

Të dhënat nga tabela më lartë janë shpalosur në detaje të kapitulli 4.3. Të hyrat dhe depozitat.

## Çështja 2 - Realizimi i buxhetit për investime kapitale - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Fillimisht AKP kishte planifikuar të realizoj 11 projekte kapitale në vlerë 94,000€. Në buxhetin final ato ishin reduktuar në shtatë projekte apo në vlerë 70,510€.

Mirëpo, edhe përpos reduktimit, realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte i ulët me vetëm 64%, ose 44,878€. Më tutje nga vlera e tërësishme e realizuar rreth 73% ishte bërë vetëm në tremujorin e fundit.

Brenda kategorisë së investimeve kapitale AKP kishte evidentuar edhe shpenzime për mallra dhe shërbime. Kjo është vërejtur në tri pagesa në vlerë 17,615€. Megjithatë, kjo vlerë nuk ishte materiale në nivel të PVF-ve.

Lidhur më klasifikimet sipas kategorive ne rekomanduam edhe në raportin e vitit 2013, mirëpo ky rekomandim nuk ishte adresuar.

**Rreziku** Dështimi për t'i realizuar projektet kapitale do ta reduktojë efektivitetin e operacioneve të AKP-së dhe do të ndikoj në dështim të arritjes së objektivave të tyre. Ndërsa, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate shkakton paqartësi në raportimin e shpenzimeve të ndodhura si dhe ndikon në mbivlerësim e shpenzimeve në një kategori, kundrejt nënvlerësimit në kategorinë tjetër.

**Rekomandimi 2** Drejtori Ekzekutiv të siguroj se përgatitja e buxhetit paraprihet nga analizat që pasqyrojnë të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Kategorizimi i tyre duhet të rishikohet. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuar lidhur me nivelin e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë.

## 4.2 Të hyrat (përfshirë donacionet e jashtme) dhe depozitat

### Përshkrimi

Te hyrat e pranuar nga AKP përfshirë edhe donacionet ishin në vlerë 1,230,610€ (1,208,179€ nga donacionet e jashtme dhe 22,431€ të hyra nga taksat administrative). Donacionet e jashtme janë dhënë nga Qeveria e Britanisë, Norvegjisë, Zvicrës dhe SHBA-ve. Pjesa me e madhe e tyre ishte shpenzuar për paga dhe mëditje. Ndërsa të hyrat vetanake janë bartur në llogarinë e Buxhetit të Kosovës.

Përveç të hyrave dhe donacioneve, AKP menaxhon edhe një fond të parave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili njihet si Fondi i Mirëbesimit. Brenda vitit 2014, pranimet e parasë së gatshme në llogari të thesarit ishin 571,525€.

Mostra jonë përfshirë të hyrat vetanake dhe depozitat ka përfshirë 22 lëndë. Bazuar në këtë konkludojmë se menaxhimi i tyre ishte bërë në pajtueshmëri të plotë me Legjislacionin aktual.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

## 4.3 Shpenzimet

### 4.3.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë se fondet publike arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas të tyre. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik.

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse AKP ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik. Ekzaminimet tona kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga iniciimi i aktiviteteve të prokurimit e deri të menaxhimi dhe realizimi i kontratave.

Testet tona substanciale, kanë përfshirë shtatë kontrata të prokurimit si dhe 35 pagesa tjera.

Bazuar në këtë konkludojmë së AKP ka arritur të sigurojë kontrolle të mira në proceset e prokurimit, me përjashtim të disa çështjeve që lidhën me procesin e vlerësimit të tenderëve dhe me hapat rreth procesimit të pagesave.

### Çështja 3 – Dobësi gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve – Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, periudha e vlefshmërisë së tenderit për procedurat me kuotim të çmimeve është 30 ditë, ndërsa për procedurat e hapura 60 ditë.

Në tri lëndë të testuara vërejtëm mangësi gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, si:

- Në dy lëndë të prokurimit me kuotim të çmimeve (“Furnizim me Material Higjienik” dhe “Furnizim me material për shtypje”) asnjëri prej Operatoreve Ekonomik (OE) nuk e kishte plotësuar pjesën e vlefshmërisë së tenderit prej 30 ditësh; dhe
- Te lënda e prokurimit “Furnizim me aparat fotokopjues” me procedurë të hapur, njëri nga OE nuk e kishte plotësuar vlefshmërinë e tenderit prej 60 ditëve.

Në të tri rastet e lartcekura komisionet vlerësuese në raportet e tyre nuk kishin bërë vlerësim të drejtë të ofertave. Pavarësisht mungesës së ofrimit të periudhës së vlefshmërisë nga OE, ata ishin vlerësuar si të përgjegjshëm.

**E gjetura** Në dosjen e tenderit “Furnizim më pajisje të TI” Lot 1, njëra ndër kriteret e kërkuara për nënshkrimin e kontratës ishte dëshmia nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që Operatori Ekonomik (OE) nuk ka obligime tatimore të pashlyera. Vlefshmëria e vërtetimit ishte kërkuar të jetë 90 ditë.

OE fitues kishte sjellë vërtetimin nga ATK më afat të skaduar. Vërtetimi përmbante datën 07.05.2014, ndërsa kontrata është nënshkruar më datë 24.09.2014. Vërtetimi kishte kaluar periudhën e vlefshmërisë prej 90 ditëve.

**Rreziku** Jo objektiviteti me rastin e vlerësimit të tenderëve rrit rrezikun për përzgjedhjen e OE të papërgjegjshëm. Si rrjedhojë e saj, mund të dëmtojnë transparencën e procesit si dhe rrezikohet që cilësia mallrave dhe shërbimet e ofruara të mos jenë në pajtim më ato të kontraktuara.

**Rekomandimi 3** Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se komisionet e vlerësimit janë duke bërë vlerësim objektiv të ofertave duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.

#### **Çështja 4 – Urdhërblerja dhe raporti i pranimit pas pranimit të faturës – Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi, procedohet urdhërblerja, pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës ekzekutohet pagesa në fjalë.
- Në 11 pagesa të testuara në vlerë 29,494€, urdhërblerjet dhe raportet e pranimit të mallit ishin procesuar pas pranimit të faturës.
- Anashkalimi i kërkesave ligjore gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave tregon se në këtë proces ende nuk ka kontrolle funksionale.
- Rreziku** Kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.
- Rekomandimi 4** Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-në, dhe me rregullat e Thesarit.

#### **4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit**

##### **Përshkrimi**

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa mostra, përfshirë shpenzimet për energji elektrike dhe qirasë. Gjatë testimit të tyre, ne nuk kemi hasur në ndonjë mangësi për tu raportuar.

##### **Rekomandimi**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### **Përshkrimi**

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP).

Gjatë auditimit ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra, përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit, pajtueshmërinë e pagesave të pagave në raport me kontratat e punës përfshirë edhe bazën e koeficienteve.

Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar së AKP, ka të vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve).

Në raportin e vitit 2013 ne kemi rekomanduar AKP-në të rishikoj mundësisë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së. Edhe përkundër zotimit të tyre ky rekomandim nuk ishte adresuar gjatë vitit 2014. Megjithëse, në muajin shkurt të vitit 2015 donacionet e dhëna me qëllim të financimit të pagave ishin ndërprerë plotësisht.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.4 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### **Përshkrimi**

Pasuritë me vlerë mbi 1,000€ sipas regjistrimit kontabël ishin në vlerë 238,098€, pasuritë me vlerë nën 1,000€ ishin 83,174€, si dhe stoqet në vlerë 21,745€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi bërë ekzaminim fizik të pasurisë së evidentuar në regjistrat e pasurisë.

AKP, kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

#### **Rekomandimi**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.4.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Në fund të vitit 2014, obligimet e papaguara të AKP-së ishin në vlerë 14,020€, që krahasuar me vitin 2013 ishin ulur për 3,860€. Te gjitha faturat e prezantuara në raportin e obligimeve dhe PVF ishin pranuar pas afatit kohor për përfundimin e vitit fiskal.

Ne kemi testuar mënyrën e evidentimit dhe raportimit të tyre dhe kemi bërë teste substanciale në disa raporte.

AKP kishte dorëzuar më kohë raportet mbi obligimet, mirëpo të gjitha ishin më vlerë zero. Kjo për arsye se Zyrtaret e financave nuk e kishin të qartë mënyrën e raportimit të obligimeve. Sipas tyre në raportet mujore duhet të përfshihen vetëm obligimet e vonuara për pagesë (faturat të cilat kanë kaluar afatin prej 30 ditësh nga data e pranimi).

Megjithatë, kjo është sqaruar gjatë auditimit dhe menaxhmenti ishte zotuar se do ta adresoj menjëherë këtë çështje.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte përgatitur planin vjetor të auditimit duke u bazuar në rreziqet e identifikuar dhe prioritetet financiare.

Për vitin 2014, NJAB kishte planifikuar nëntë auditime të rregullta. Ne kemi vlerësuar se të gjitha auditimet ishin përfunduar sipas planit dhe raportet ishin të një cilësie të lartë. Ato i ofruan menaxhmentit një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontroleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Gjithashtu NJAB ka bërë një raport përmbledhës të punës së tyre për vitin 2014, në të cilin prezantohet performanca e saj. Në raportet e përfunduara, NJAB kishte dhënë 16 rekomandime, prej të cilave 13 ishin adresuar, ndërsa tri janë në proces të adresimit. Ndërsa rekomandimet e pa adresuara pritet të adresohen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Me tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate.			Nuk është adresuar.
4.4.1. Prokurimi	Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPD dhe me rregulla të thesarit.			Nuk është adresuar.
4.4.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Drejtori ekzekutiv në bashkëpunim më donatorët t'i rishqyrtojnë vendimet e marra dhe të rishikoj mundësinë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së. Gjithashtu të siguroj se pagesat e sigurimeve shëndetësore kanë bazë të qëndrueshme ligjore.			Nuk është adresuar, gjatë vitit 2014, mirëpo, ky rekomandim nuk është më i aplikueshëm pasi që nga muaji shkurt 2015 janë ndërprerë donacionet për këto qëllime.